



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË  
ZGJEDHJEVE**

**Nr. 14**

Datë: 27. 04. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

-Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit Vjetor për Kuvendin e Kosovës 2021

-Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit Tre mujor i Zbatimit të Planit të Punës

**3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Ftesës së OSCE-ODIHR dhe IFES-it**

**4. Të ndryshme.**

---

## **RENDI I DITËS**

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Fillimisht, kryetari Radoniqi, paraqiti agjendën e mbledhjes, dhe pyeti anëtarët e KQZ-së nëse, kanë diçka për rendin e ditës. Nuk pati asgjë për t'u shtuar, dhe anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës me vota unanime.

### **2. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

#### **1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit Vjetor për Kuvendin e Kosovës 2021**

**Arianit Elshani**, tha se këshilli ka shqyrtuar këtë draft raport, duke konstatuar se në vitin e kaluar KQZ, me sukses ka organizuar dy palë zgjedhje, ato qendrore dhe lokale, dhe se të njëjtat janë vlerësuar mirë edhe nga institucionet ndërkombëtare. Elshani, tha se në raport, është paraqitur një përmbledhje e detajuar e aktiviteteve të zhvilluara nga KQZ. Janë, tha ai 42 aktivitete nga plani i punës, prej tyre 11 pjesërisht të realizuara, dhe 8 kanë mbetur të porealizuara...por që janë bartur në planin e këtij viti. Elshani, pasqyroi disa aktivitete si më të rëndësishmet të realizuara nga plani i KQZ-së...

Lidhur me raportin, diskutoi z. **Sami Kurteshi**, i cili tha se ka nxjerrë një analizë të gjerë të raportit, dhe tha se janë disa dhjetëra elemente, vërejtje, korrigjime, komente etj. Z. Kurteshi, tha se për shkak se ky raport shkon në Kuvend dhe votohet nga deputetët, atëherë duhet kushtuar vëmendje të veçantë ! Ai, i paraqiti ato dhe i shpjegoi në detaje para anëtarëve të KQZ-së, duke dhënë vlerësime, këshillime, shpjegime dhe vërejtje mbi përmbajtjen e raportit...

**Valmir Elezi**, zëdhënës, tha se raporti është një punë e përbashkët në Sekretariat. Ai, bëri shpjegimet dhe zbatimet e tij në vërejtjet e bëra, dhe faktin se çka dhe pse, disa të dhëna, përmbajtje, rekomandime etj., janë paraqitur në raport...

**Kreshnik Radoniqi**, tha se pothuajse të gjithë anëtarët, pra të gjithë anëtarët, u pajtuan me vërejtjet e z. Kurteshi, dhe pa marrë parasysh, raporti – kështu siç po kërkojmë të kthehet dhe të përmirësohet...

Nuk do ta hedhim në votim...

**Burim Ahmetaj**, krye shef i SKQZ-së, tha se i kemi marrë vërejtjet nga z. Kurteshi, dhe se ne menjëherë do të punojmë që raportin ta përmirësojmë sipas vërejtjeve dhe konstatimeve tuaja...

**Sami Kurteshi**, tha se raportin e voton KQZ dhe e nënshkruan kryetari ! Natyrisht, shumë çështje ndoshta edhe kanë mbetur pa u shqyrtua, por kryesorja është që ne ta dërgojmë një raport të mirë: vërejtjet janë...

**Alim Rama**, dha po ashtu vërejtjet dhe sugjerimet në çështjet konkrete. Ai, kërkoi që të përmirësohet raporti mbi vërejtjet dhe konstatimet qoftë të bëra nga z. Kurteshi, qoftë përgjatë shqyrtimit nga anëtarët në mbledhje....

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Arianit Elshani, Sami Hamiti, Kreshnik Radoniqi

## **2. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit Tre mujor i Zbatimit të Planit të Punës:**

**Arianit Elshani**, tha se këshilli ka shqyrtuar edhe raportin tremujor të zbatimit të planit të punës, dhe se në raport janë paraqitur në detaje aktivitetet: nga 57 aktivitete të planifikuara, 13 janë realizuar, disa aktivitete janë në proces të realizimit...

Në cdo takim, ai tha se KOZ është duke e përcjellë se si po ecën, realizimi i planit të punës...

Më tej, në këtë pikë diskutuan: **Alim Rama**, Sami Hamiti, Arianit dhe, Čemailj Kurtiši.

Në fund, raporti u miratua me vota unanime, por me kusht që në raport të inkorporohen vërejtjet e bëra nga anëtarët e KQZ-së përgjatë shqyrtimit dhe analizës...

## **3. Shqyrtimi dhe Miratimi i Ftesës së OSCE-ODIHR dhe IFES-it**

**Kreshnik Radoniqi**, tha se në bazë të kësaj ftese, në Mal të Zi kërkohet që duhet të shkojmë dy persona, kurse nga ftesa IFES një pjesëmarrës...

Unë, OSCE-ODIHR –it ua kam konfirmuar pjesëmarrjen time...! Ju, çfarë mendoni...?

Pas shqyrtimit, në fund anëtarët e KQZ – së vendosen që në Republikën e Maqedonisë ( sipas ftesës së IFES-it ), KQZ të përfaqësohet nga z. Alim Rama, kurse në Mal të Zi (sipas ftesës së OSCE – ODIR ), KQZ të përfaqësohet nga z. Kreshnik Radoniqi dhe Arianit Elshani.

#### **4. Të ndryshme.**

Në të ndryshme, kryetari Radniqu, njoftoi në mbledhje se, është duke u përgatitur raporti nga vizita e KQZ –së në zgjedhjet në parlamentare në Slloveni...